



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 0839 Prot.

Roskovec, më 01, 11 2023

VENDIM

NR 87 .DATË 31 .10 .2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES KËSHILLIT BASHKIAK  
PËR MUAJIN SHTATOR 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.09.2023, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Shtator 2023.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5909/1 Prot.

Roskovec, më 02.10.2023

**Procesverbal Nr.12**

*-I mbajtur sot, datë 29.09.2023, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së kaluar.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2023.
5. Për faljen e tarifës për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit për vitin 2023, për fermerët të cilët janë anëtarë të Odës së Bujqësisë .
6. Për miratimin e dokumentit të PBA 2024-2026 të rishikuar.
7. Raport i monitorimit për 4-mujorin e II viti 2023.
8. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>15</sup>

Këshilltarët prezent: A.Plaka,E.Musko,E.Çepele,F.Hoxha,L.Goga,E.Buzi,E.Kaçeli,N.Zeka  
H.Hajdini,E.Toska,S.Bibo.

Këshilltarët që mungojnë:

Rr.Hazizi,Zh.Metushi,E.Xhaxhaj,Dh.Malka,J.Begaj,P.Toro,A.Hoxha,V.Çepele,A.Pelo,F.Feleqi.

Prezent nga bashkia:Nënkryetari M.Goga,Dr.Ekonomisë S.Çepele,P/Shërbimit Social  
S.Saliaj,P/Sek.Ujitjes dhe Kullimit V.Kola .

Me plotësimin e kuoromit,Kryetari i Këshillit hap mbledhjen.Prezent në fillimin e mbledhjes janë 11 këshilltarë.Kryetari i falenderon këshilltarët për pjesmarrjen në mbledhje.Pasi keni marr materjalet përkatëse,ju ftoj të shpreheni përsa i takon miratimit të rendit të ditës për mbledhjen e sotme.

- 1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së kaluar.

Informacioni ka të bëjë me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar, ndarjen e akteve normative dhe dërgimin e tyre në Prefekturë, si dhe miratimi i tyre nga Prefektura.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Gusht 2023.

Elmazi-a ka ndonjë vendim nga qeveria për rritje të pagesës së 6% për familjet? Sidorela-nuk ka ardhur akoma asnjë vendim qeverie, në momentin që do vij do ua bëjmë me dije. Nuk ka më diskutime. Hidhet në votim projekt-vendimi i 6% për muajin Gusht 2023 dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

5. Për faljen e tarifës për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit për vitin 2023, për fermerët të cilët janë anëtarë të Odës së Bujqësisë .

Viktor Kola-sqaron projekt-vendimin. Duke marr shkas nga sfidat që po kalon bujqësia vitet e fundit, dhe për shkak të ndryshimeve klimaterike, rritjes së çmimit, lind nevoja e organizimit të bashkimit të fermerëve në organizata të tilla, në të cilat do të shprehin shqetësimet e tyre. Në bashkëpunim me institucionin tonë, një grup fermerësh të suksesshëm të zonës kanë shprehur dëshirën të krijojnë një organizim të quajtur Oda e Bujqësisë, ku ata do të shprehin të gjitha nevojat ose politikat që duhen ndërmarr në bujqësi, ose lehtësirat që mund tju ofrojmë ne si institucion. Për të marr zhvillim kjo nismë, ne na është dukur ide shumë e mirë që t'ju bëjmë një lehtësi fiskale, duke falur tarifën e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit për vitin 2023, për fermerët anëtarë të kësaj Ode. Janë 14 fermer në këtë Odë, realisht nga kjo lehtësi përfiton për momentin vetëm 1 fermer, i cili ka tokë në pronësi. Ne do shikojmë edhe mundësinë e fermerëve të tjerë, të cilët kanë marr tokë me qira, nëse u lind e drejta edhe atyre për faljen e kësaj tarife. Kryetari-Oda e Bujqësisë Roskovec ka hapsirë ligjore dhe mundësinë për të aplikuar direkt për fonde nga BE-ja ? Sa është numri minimal i fermerëve që duhet të jenë në përfaqësinë e kësaj Ode për të aplikuar ? Viktori – Oda është një organizatë pa të drejtë fitimprurëse, është e drejta e çdo individi të aplikoj për fonde, ose mund të bëhet një bashkim fermerësh që të aplikojnë. Kjo është një praktikë e re për Shqipërinë. Maksi – 2 janë qëllimet kryesore të kësaj nisme : 1. Për të mbledhur shqetësimet dhe problemet e fermerëve. 2. Për thithjen e fondeve nga BE-ja. Do regjistrohen me numer Nipt si shoqëri aksionere. Nuk ka më diskutime. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 11 vota pro.

6. Për miratimin e dokumentit të PBA 2024-2026 të rishikuar.

Selmani-ky është projekt pas miratimit të PBA ose afateve përfundimtare në Korrik, kjo është vendimmarrje për rishikimin e këtyre taveve, dhe vendimmarrja tjetër është në Dhjetor, natyrisht pas dëgjësive publike që do realizojmë në Tetor-Nëntor, ku do miratohet buxheti për vitin 2024 dhe PBA përfundimtare 2024-2026. Në lidhje me këtë materjal, i cili është goxha voluminoz, ku unë kam prekur të gjitha ndryshimet që do ndodhin, realizimet, mosrealizimet, më thjesht ndryshimet kanë ndodhur si pasojë e vendimmarrjeve që ne kemi marr për rritjen e nivelit të pagave, duke e konsideruar këtë të përbalueshme nga fondi i grandit të pakushtëzuar dhe atë specifik. Në total për vitin 2024 tavanet ndryshojnë sipas materjalit që ju keni. Në total tavani i përgjithshëm ndryshon me 17.8 milion lekë, kryesisht kjo nga rritja e pagave dhe duke mos prekur shpenzimet kapitale ose investimet. Në 2025 janë pothuajse ato nivele. Maksi-të gjitha sugjerimet që u bënë nga opozita

mbledhjen e mëparshme besoj janë pasqyruar.Leksi-Drejtor ke bërë një punë shumë të mirë.Nuk ka më diskutime.Hidhet në votim projekt-vendimi i miratimit të dokumentit të PBA 2024-2026 të rishikuar,sipas materjalit dhe miratohet unanimitisht me 11 vota pro,me ndryshime.

7.Raport i monitorimit për 4-mujorin e II viti 2023.

Selmani-është vazhdim i monitorimit të zbatimit të buxhetit gjatë vitit,i cili ka 3 monitorime me tre 4-mujor,ky është 4-mujori i dytë.Në tabela ju kemi paraqitur në mënyrë të hollësishme shpenzimet për çdo program,çdo artikull si paga,sigurime,shërbime dhe shpenzime kapitale.Realizimet janë ato,duke i krahasuar si me planifikimin vjetor ashtu dhe atë 8-mujor.Te tabela e investimeve keni të pasqyruar vlerën e projektit,realizimin gjatë këtij viti dhe sa ka ngel pa u realizuar.Mendoj me këtë ecuri të kemi një realizim të kënaqshëm edhe në investime,të cilat do pasqyrohen gjatë këtij 4-mujori.Nuk ka pyetje.Kryetari e falenderon për punën e bërë dhe sqarimet e dhëna.

8.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Kryetari i jep fjalën Nënkryetarit të bashkisë Maksit për një informacion në lidhje me ecurinë e deritanishme të procesit të përzgjedhjes së kryepleqve sipas vendimit të këshillit.Maksi-sipas VKB Nr.70 për zgjedhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave,nga 14 fshatra nën juridiksionin e Bashkisë Roskovec,ka përfunduar procesi në 11 fshatra.Ka përfunduar në Jagodinë,në Njësinë Administrative Strum ka përfunduar në Velmish,Suk 1,Suk 2,Arapaj,nuk ka përfunduar në Strum.Në Njësinë Administrative Kuman ka përfunduar në Marinëz,Kuman dhe Vidhishtë,nuk ka përfunduar në Luar.Në Njësinë Administrative Kurjan ka përfunduar në Kurjan,Mbërs dhe Vlosh,nuk ka përfunduar në Ngjeqar.Pra janë 3 fshatra Ngjeqar,Luar,Strum ku nuk ka përfunduar,arsyet kanë qënë ngarkesa e punës e para,dhe e dyta për arsye familjare të ish kryetarëve të fshatrave Strum dhe Luar,ndërsa përsa i përket Ngjeqarit procesi ka ngelur në mes,dhe këto ditë sipas një grafiku që do riorganizojmë,në mungesë edhe të Kryetares së Bashkisë për ta shpallur publikisht,do ta vazhdojmë procesin dhe për ta mbyllur edhe në këto fshatra.Ermiramund të na i thuash emrat për njësinë Kurjan?Maksi-Jagodinë Hekuran Çepele,Marinëz Haxhi Ruko,Vlosh Gani Hoxha,Suk 1 Kujtim Zoga,Suk 2 Shkëlqim Toska,Velmish Dashnor Hazizi,Mbërs Behar Lamaj,Kurjan Xhevair Baxhia,Vidhishtë Muharrem Senka,Kuman Tomorr Metani,Arapaj Agron Dogani.Këshilltarët e falenderojnë për informacionin.Ermira-shqetësim në lidhje me sahatin e ujit në shkollën e Kurjanit.Shkolla sahatin e ka tek depoja,i gjithë tubacioni është bërë copë-copë,aq sa harxhohet të paguhet nga bashkia,por të merren masa që sahati të vihet tek shkolla,jo në dalje të depos.Problem me tualetet e shkollës,janë prishur të gjitha kasetat e ujit dhe ato rrinë takuar.Elizabeta-edhe tek shkolla jonë janë problem kasetat e ujit dhe bolieri i dushit është stakuar.Të shtohen edhe pak detergjentët në shkollë,sanitarët shprehin se kanë mungesë me detergjentët e pastrimit.Për trotuarin e rrugës së luleve nuk e di për asfaltin,do asfaltohet?edhe me ndriçimin ka problem atje,fiken-ndizen llambat.Leksi-pyet për hapjen e rrugës që miratua 2 mbledhje më parë,ku ka ngelë procedura ?Maksi-në 3 Tetor mbyllet procedura e tenderimit dhe fillon puna.Kryetari-Kam 2 shqetësime që dua të merren në konsideratë.1.Rruga në Luar që të çon tek pylli me pisha nga rruga kryesore,është një lagje dhe janë shumë banor që kanë shqetësim prej shumë kohësh dhe deri tani nuk kemi arritur ta zgjidhim.2.Në Kuman sa herë bie shi tek lagja Biçeç është një shtëpi që përmytet,atje duhet të disiplinohen ujërat.Kryetari mbyll diskutimet përsa i takon pikave të rendit të ditës.Kryetari-dua të ndaj dy gjëra jashtë mbledhjes.E para-ne ju kemi dhënë mundësinë që kur japim njoftimet e mbledhjes,kemi përcaktuar tek shënimet poshtë dhe jemi munduar të ndajmë pikat përkatëse sipas komisionit që duhet ti shikoj.Duke qënë se materialet janë voluminoze,do ju lutesha anëtarëve të komisionit përkatës ti shikojnë me përparësi



pikat e rendit të ditës,në mënyrë që të kemi më pak diskutime dhe të jemi më të qartë ditën e mbledhjes.Në lidhje me iniciativën që kemi marr për rregulloren e këshillit,nga informacioni që morra është një rregullore e këshillit e cila është goxha voluminoze,dhe po diskutohet që ta ndërrojmë atë rregullore me një rregullore tjetër,i cili është manual më i shkurtër dhe praktik.Nuk e di sa nga ju janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe janë dakort,unë po të jetë e nevojshme marr dhe iniciativën,sepse dikush duhet ta marr iniciativën për ndryshimin e rregullores.Mirë do ishte që të shikoni rregulloren që kemi dhe të jepni vlerësimin tuaj,nëse do bëjmë ndryshim mbi atë rregullore apo të marrim një rregullore të re.Rregulloret nuk i bëjmë dot ne,ne japim opinionet tona.Na ka ardhur një kërkesë në emër të këshillit nga shoqëria e Ujësjellës-Kanalizime për ndryshimin e tarifave të ujit të pijshëm,bëhet fjalë për një rritje të moderuar të vogël por po shikojmë procedurën ligjore për ta sjellë në mbledhjen tjetër të këshillit.Vendimi ynë do shkojë pranë Entit Rregullator.Leksi-ne do e diskutojmë,sepse një rritje e vogël del rritje e madhe,kjo çështje ka ndjeshmëri të madhe për qytetarët.Afrimi-dje kemi zhvilluar dëgjese publike për këtë çështje.Elmazi-dëgjesa të bëhet në fshatra,jo vetëm në Roskovec.Mbyllet mbledhja.

**Sekretar**

**Arlinda Hajdini**



**Kryetar**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6840 prot

Roskovec, më 01. 11. 2023

VENDIM

Nr. 88 datë 31.10/2023

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR  
DERI 6% PËR PERIUDHËN 1-30 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2,9,24, të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë dhe”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmëse ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB Nr.3 datë 27.01.2023 “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Shtator 2023, në total 17 (shtatëmbëdhjetë) familje me fond total prej 83665 (tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë. Konkretisht:

**PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Shtator 2023, 4 (katër) familje me një fond 12173 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

**PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE STRUM**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Shtator 2023, 1 (një) familje me një fond 2178 (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

## **PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Shtator 2023, **5 (pesë)** familje me një fond **32413 (tridhjetë e dy mijë e katërqind e trembëdhjetë)** lekë.

## **PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN**

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Shtator 2023, **7 (shtatë)** familje me një fond **36901 (tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e një)** lekë.

- Ngarkohet sektori i Financës dhe sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**



**Bashkia Roskovec**

Shtator 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Ates Mbiemer	Nr. dosje	Nr. Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Agron Osmën Çanta		1	Familje në nevojë	2178
2	Bukuroshe Sali Çepele		1	Familje në nevojë	3146
3	Selvi Rystem Çepele		1	Familje në nevojë	3146
4	Zhaneta Ferrik Hatillari		2	Familje në nevojë	3703
	<b>Shuma</b>				<b>12173</b>

Mbyllet me nr rendor 4(katër)

**KRYETAR KËSHILLI**

Afrim Plaka





Njesia Administrative Strum

Shtator 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emri Atesit Mbiemri	Nr. dosjes	Nr. Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmës	Shuma
1	Drita Mehmet Cepce		1	Familje në nevojë	2178
	<b>SHUMA</b>				<b>2178</b>

Mbyllet me numrin rendor 1 (një)



Njësia Administrative Kuman  
Shtator 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Atesë Mbiemër	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	ndihmes	Shuma
1	Alketa Flamur Lamo		5	Familje në nevojë	11880
2	Katolina Mevlud Shurdha		3	Familje në nevojë	8712
3	Klaudja Viktor Metaj		2	Familje në nevojë	5940
4	Sefret Tofik Hoxha		2	Familje në nevojë	3703
5	Aishe Jonus Akulli		1	Familje në nevojë	2178
<b>5</b>	<b>Shuma</b>		<b>13</b>		<b>32413</b>

Mbyllet me nr rendor 5(pesë)

KRYETAR KËSHILLI  
Afrim Plaka



Njësia Administrative Kurjan  
Shtator 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Yzedin Shaban Panahori		2	Familje në nevojë	3703
2	Agim Mino Zeka		5	Familje në nevojë	14652
3	Donika Vexhi Kuka		1	Familje në nevojë	3146
4	Ramadan Gani Koronaj		1	Familje në nevojë	5720
5	Donika Hysni Lika		1	Familje në nevojë	2178
6	Gëzim Hysen Goriçani		1	Familje në nevojë	3146
7	Kamber Riza Lamaj		3	Familje në nevojë	4356
	Shuma				36901

Mbyllet me nr rendor 7 (shtatë)

KRYETAR KËSHILLI

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 684 prot

Roskovec ,më 01.11 .2023

VENDIM

NR 89 .DATË 31.10 .2023

PËR  
MIRATIMIN NË PARIM DHE AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË PËR  
LIDHJEN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME FEDERATËN  
SHQIPTARE TË FUTBOLLIT (FSHF)

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.6, neni 25, pika 4 dhe nenit 54, gërma k; Ligjin Nr. 79/2017 “Për Sportin”, neni 8 pika 3, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF) për bashkëfinancimin e zbatimit të projektit me objekt: “Ndërtimi i fushës së sportit”, pjesë e projektit të rehabilitimit urban të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec.
- 2- Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF).
- 3- Pjesë përbërëse e Vendimit është Marrëveshja e Bashkëpunimit me Federatën Shqiptare të Futbollit (FSHF).
- 4- Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6842 prot.

Roskovec, më 01.11.20223

VENDIM

Nr. 90, datë 31.10.2023

PËR

**DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË LANDFILLIT TË MBETJEVE URBANE FIER NGA AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 3, 8, 9, 14, 23 pika 10 dhe 54 shkronja “gj” dhe “k” të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; të nenit 21, 22, 23 të Ligjit Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe shkresës Nr. 3080, datë 22.09.2023 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara protokolluar në Bashkinë Roskovec me Nr. 5781, datë 26.09.2023, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Dhënie e dakordësisë për Bashkinë Roskovec për marrjen në përdorim me qira 1 (një) Euro, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë vetëm të pjesës së landfillimit të mbetjeve urbane Fier, peshimit dhe rrugës hyrëse të Impjantit të Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.
2. Dhënie e Autorizimit për Kryetarin e Bashkisë Roskovec, për të zhvilluar negociatat me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë për lidhjen e kontratës së qirasë, për pjesën takuese të bashkisë Roskovec në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi.
3. Dhënie e Autorizimit për Kryetarin e Bashkisë Roskovec për të zhvilluar negociatat me Bashkitë përbërëse të Qarkut Fier, të cilat depozitojnë mbetje urbane në Impjantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier, për lidhjen e marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe përcaktimit të një strukture të përbashkët, e cila do të kryejë për llogari të gjithë

- Bashkive të Qarkut Fier, menaxhimin e pjesës së depozitimit, të peshimit, dhe rrugës hyrëse në Impjantin e Mbetjeve Urbane të Qarkut Fier.
4. Efektet financiare që do të nevojiten për funksionimin e strukturës së përbashkët menaxhuese, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për depozitimin, mirëmbajtjen, menaxhimin e landfillit (fuqi punëtore, si dhe shpenzimet e përditshme operative), për pjesën takuese të Bashkisë Roskovec, do të përballohen nga buxheti i Ndërmarrjes së Pastrimit të Bashkisë Roskovec.
  5. Këto efekte financiare do të fillojnë të përballohen nga Ndërmarrja e Pastrimit e Bashkisë Roskovec, pas momentit të marrjes në dorëzim të pjesëve të përshkruara më sipër nga Bashkitë e Qarkut Fier, që depozitojnë mbetjet urbane në Impjantin e Mbetjeve dhe lidhjes mes tyre të marrëveshjes së bashkëpunimit.
  6. Me miratimin e këtij vendimi ndërpritet pagesa prej 1400 lekë/ton mbetje të depozituara, e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 35, datë 30.03.2023 “Për zbatimin e çmimit për ton/mbetje urbane dhe lidhjen e aktmarrëveshjes për mbetjet që depozitohen në landfill (incenerator Fier) dhe përcaktuar në Akt-Marreveshjen “Për depozitimin e mbetjeve pranë zonës së trajtimit të mbetjeve Landfillin Fier” të lidhur midis Bashkisë Roskovec dhe Shoqërisë “Integrated Technology Waste Treatment Fier” sh.p.k (e administruar nga Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë) të protokolluar në Bashkinë Roskovec me Nr.2281/2, datë 06.04.2023.
  7. VKB Nr. 35, datë 30.03.2023 “Për zbatimin e çmimit për ton/mbetje urbane dhe lidhjen e aktmarrëveshjes për mbetjet që depozitohen në landfill (incenerator Fier), shfuqizohet.
  8. Ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrja e Pastrim, Gjellbërim dhe Mirëmbajtje Varreza, Bashkia Roskovec për zbatimin e këtij vendimi.
  9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6843 prot

Roskovec.më 01.11.2023

VENDIM

NR 91 . DATË 31.10 .2023

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “REHABILITIMI URBAN I NJË PJESE TË  
BLOKUT NR.3 NË QËNDËR TË QYTETIT ROSKOVEC (FAZA 1)”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar ; neni 54, gërma “k”, të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar; të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e projektit me objekt: “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr.3 në qendër të qytetit Roskovec (faza 1)”.
2. Qëllimi i projektit është: “Rehabilitimi i një pjese të Bllokut nr.3 duke e kthyer në shërbim të qytetarëve për ti dhënë një pamje të re dhe funksionale qytetit duke u mbështetur në Strategjinë Territoriale të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec”.
3. Ky projekt do të përmbajë këto nënobjekte:
  - 3.1 Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregëtare
  - 3.2 Ndërtimi i parkut të ri të qytetit
  - 3.3 Sistemimi i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të
  - 3.4 Ndërtimi i Postës së re të Policisë (Projekt ekzistues i miratuar nga Bashkia Roskovec)
4. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektori i Zbatueshmërisë së Investimeve për zbatimin e këtij vendimi .
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6844 Prot.

Roskovec, më 01.11 2023

VENDIM

NR 92 .DATË 31.10 .2023

"PËR SHITJEN E PRONËS SË PALUAJTSHME NË PRONËSI TË BASHKISË  
ROSKOVEC, SIPAS PROGRAMIT "BANESË ME KOSTO TË ULËT"

Në mbështetje të Kodi Civil nenet: 83, 705, 750 dhe 751; të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 gërmat 'a' dhe 'c', neni 24 pika 2, neni 54 gërma 'e'; Ligji Nr.8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, nenet 11 e 12; Ligjit Nr.87441, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 8; të ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, neni 13 pika 1 gërma 'b' paragrafi "ii", neni 16, gërma 'a' paragrafi 'iv', neni 44 pika 2, neni 49 pika 1; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.76 datë 18.10.2018 "Për miratimin e investimit për ndërtimin e një godine 3-katëshe për strehim social", Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin për shitjen e pronave publike në pronësi të bashkisë Roskovec sipas çertifikatës së pronësisë, hartës treguese dhe kartelave të pasurisë bashkëlidhur, sipas zbatimit të programit "Banesë me kosto të ulët".
- 2- Miratimin për shitjen e pronave publike, familjes e cila rezulton si e pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore, si kategori me përparësi sipas Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social", neni 16, gërma 'a' paragrafi 'iv':  
*Afrim Çobo*
- 3- Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së këtyre pronave të paluajtshme nëpërmjet shitjes, do të bëhet me akt noterial dhe do të regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi.
- 4- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR  
Afrim Plaka

